

# GJYKATA E APELIT GOSTIVAR



## RAPORTI VJETOR



Zhivko Brajkovski 1



info@asgostivar.mk



042/221-544

# 2023

## PËRMBAJTJA

1. <u>PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS</u>	3
2. <u>ADMINISTRATA GJYQËSORE</u>	4
3. <u>KUALITETI I PUNËS NË NIVEL TË GJYKATËS</u>	4
4. <u>KUALITETI I PUNËS NË NIVEL TË SEKTORIT:</u>	
A) SEKTORI PENAL _____	5
B) SEKTORI CIVIL _____	6
5. <u>KUALITETI I PUNËS NË NIVEL TË SEKTORIT:</u>	
A) SEKTORI PENAL _____	7
B) SEKTORI CIVIL _____	8
6. <u>GJENDJA ME LËNDËT E VJETRA</u>	9
7. <u>RAPORT PËR BURIMET NJERËZORE:</u>	
POZICIONET ORGANIZUESE _____	10
SISTEMATIZIMI _____	10
FUNKSIONI I GJYKATËS _____	12
SHËRBIMI GJYQËSOR _____	12
VLERËSIMI I SIGURISË SË TË PUNËSUARVE, PALËVE, LËNDËVE DHE PAISJET E GJYKATËS _____	13
8. <u>RAPORT PËR HARMONIZIMIN E PRAKTIKËS GJYQËSORE</u>	14
9. <u>RAPORT PËR VIZITAT E KRYERA TË GJYKATAVE MË TË ULTA</u>	15
10. <u>RAPORT PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN</u>	16
11. <u>RAPORT PËR TEKNOLOGJINË INFORMATIKE</u>	18
12. <u>RAPORT PËR PAISJEN DHE MIRËMBAJTJEN E NDËRTESESË SË GJYKATËS</u>	19
13. <u>RAPORT PËR PROKURIMET E PLANIFIKUARA DHE TË REALIZUARA</u>	19

## 1. PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Gjykata e Apelit Gostivar si organ i pavarur shtetëror, gjykon mbi bazë të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, ligjet dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën, me çka siguron zbatimin e vetëm të drejtësisë dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut.

Gjatë periudhës raportuese, gjykata me angazhim maksimal të të gjithë të punësuarve – gjykatësve, kuadrit profesional dhe kuadrit administrativo-teknik, mbeti i përqëndruar në kryerjen efikase dhe kualitative të funksionit gjyqësor, në korniza të kompetencave që ka me vëmendje maksimale për realizimin e plotë të programit të punës për vitin 2023.

Në këtë periudhë gjykata gjithsej në punë ka pasur 3.869 lëndë, që janë 941 lëndë të transferuara nga viti i mëparshëm dhe 2.928 lëndë të reja të pranuar. Gjatë periudhës raportuese, gjykata ka zgjidhur 3.221 lëndë, ndërsa në fund të vitit kanë mbetur të pazgjidhura 648 lëndë.

Gjendja në lidhje me kohëzgjatjen e procedurës është si vijon:

- **Deri 1 muaj** janë zgjidhur 956 lëndë ose 29,68%,
- **Nga 1 deri 3 muaj** janë zgjidhur 596 lëndë ose 18,50%,
- **Nga 3 deri 6 muaj** janë zgjidhur 956 lëndë ose 29,68%,
- **Mbi 6 muaj** janë zgjidhur 713 lëndë ose 22,14%.

Regjistri	Lëndë të pambaruara në fillim të vitit	Lëndë të reja të pranuar	Lëndë që janë duke u punuar përsëri	Gabimisht të regjistruar	Gjithsej lëndë në punë	Lëndë të zgjedhura	Lëndë të pazgjedhura
"KZH" lëndë penale të shkallës së dytë	221	405	0	0	626	590	36
"KZHM" lëndë penale të shkallës së dytë në procedure kundër të miturve	1	16	0	0	17	15	2
"KSZH" këshill penal i shkallës së dytë	1	138	0	0	139	136	3
"PRKZH" lëndë për kundërvajtje të shkallës së dytë	5	503	0	0	508	502	6
"KR" regjistri për lëndë të ndyshme penale	3	47	0	0	50	48	2
"GZH" lëndë civile të shkallës së dytë	486	1031	0	0	1517	1134	383
"ROZH" lëndë të shkallës së dytë konteste të	202	614	0	0	816	642	174

marrdhënieve të punës							
"TSZH" lëndë të shkallës së dytë në konteste të tregtisë	21	127	0	0	148	106	42
"R" regjistri për lëndë të ndryshme civile	1	47	0	0	48	48	0
<b>GJITHSEJ</b>	<b>941</b>	<b>2.928</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>3.869</b>	<b>3.221</b>	<b>648</b>

## 2. ADMINISTRATA GJYQËSORE

Në lidhje me administratën gjyqësore, fluksi i lëndëve të reja është 1.322 lëndë, që paraqet ulje prej 347 lëndëve në raport me vitin e kaluar.

Gjatë periudhës raportuese të gjitha lëndët e administratës gjyqësore janë mbaruar.

Regjistri	Lëndë të pambaruara në fillim të vitit	Lëndë të reja të pranuar	Gabimisht të regjistruara	Gjithsej lëndë në punë	Lëndë të zgjedhura	Lëndë të pazgjedhura
SU-regjistri për administratën gjyqësore	0	1139	0	1139	1139	0
SU-DOV-regjistri konfidencial i administratës gjyqësore	0	3	0	3	3	0
SU-STR-DOV-regjistri konfidencial i rrjeptë i administratës gjyqësore	0	0	0	0	0	0
UPP-regjistri për evidencë të parashtrësive dhe ankesave	0	46	0	46	46	0
IZZ-regjistri për largimin e gjykatësve ose kryetarit	0	128	0	128	128	0
SPI- regjistri për qasje të lirë deri te informatat	0	6	0	6	6	0
<b>GJITHSEJ</b>	<b>0</b>	<b>1.322</b>	<b>0</b>	<b>1.322</b>	<b>1.322</b>	<b>0</b>

### 3. KUALITETI I PUNËS NË NIVEL TË GJYKATËS

Sipas të dhënave nga lëndët e kthyer nga ana e Gjykatës Supreme, gjykata ka mbajtur kualitetin e lartë të punës.

Janë kthyer gjithsej 93 vendime gjyqësore, nga të cilët **të vërtetuara** janë 70 vendime ose 2,17% nga lëndët e zgjidhura, **të ndryshuara** janë 6 vendime ose 0.19% nga lëndët e zgjidhura **dhe të anuluar** janë 17 vendime ose 0,53% nga lëndët e zgjidhura.

Të vërtetuara		Të anuluar		Të ndryshuara	
70	2.17%	17	0.53%	6	0,19%

Në lidhje me përqindjen e vendimeve të kthyer nga Gjykata Supreme, **janë vërtetuar** 75,27% nga numri i lëndëve që kanë qenë jashtë mjetit të zakoshëm juridik, **të ndryshuara** janë 6,45% nga numri i lëndëve që kanë qenë jashtë mjetit të zakoshëm juridik dhe **të anuluar** janë 18,28% nga numri i lëndëve që kanë qenë jashtë mjetit të zakoshëm juridik.

Vendime sipas MJJ	Të vërtetuara		Të anuluar		Të ndryshuara	
Numri	numri	%	numri	%	numri	%
93	70	75,27%	17	18,28%	6	6,45%

### 4. PUNA E LËNDËVE NË NIVEL TË SEKTORËVE

#### A) SEKTORI PENAL

Në sektorin penal në pajtim me orarin për punë të gjykatësve në Gjykatën e Apelit Gostivar për vitin 2023, kanë vepruar 5 (pesë) këshilla penal. Nga këto 2 (dy) këshilla kanë vepruar me lëndët e regjistrin 'KZH' – lëndë penale të shkallës së dytë dhe regjistri 'PRKZH' – lëndë për kundërvajtje të shkallës së dytë, një këshill penal për zgjidhje të lëndëve penale nga regjistri 'KZHM', në pajtim me Ligjin për drejtësi për të miturit. Pasataj, këshill i posaçëm që vepron posaçërisht me lëndët të regjistruara me regjistrin 'KSZH' dhe 'KR' dhe një këshill penal nga pesë gjykatës për vepra penale që me ligj është paraparë dënimi me burg në kohëzgjatje prej 15 vite deri në burgim të përjetshëm.

Në sektorin penal në periudhën raportuese gjithsej në punë ka pasur 1.340 lëndë nga të cilët 231 janë transferuar si të pazgjidhura nga viti i kaluar dhe 1.109 lëndë janë pranuar të reja, me çka gjykata gjithsej ka zgjidhur 1.291 lëndë, ndërsa në fund të vitit kanë mbetur të pazgjidhura 49 lëndë që transferohen në vitin e ardhshëm.

Në lidhje me vitin paraprak në gjykatë janë pranuar 1.468 lëndë të reja, në periudhën raportuese ky numër është zvogëluar për 359 lëndë dhe numri është 1.109 lëndë. Zvogëlimi shihet në të gjitha regjistrat në këtë sektor, përpos regjistrin 'KR' ku ka rritje për 10 lëndë të reja të pranuar në lidhje me vitin e kaluar.

Numri i lëndëve të zgjidhura në këtë sektor, në periudhën raportuese është zvogëluar për 128 lëndë në raport me vitin e mëparshëm dhe numri është 1.291 lëndë. Gjithashtu edhe numri i lëndëve të pazgjidhura është zvogëluar për 182 lëndë dhe numri është 49 lëndë që transferohen për vitin e ardhshëm.

Gjatë periudhës raportuese në gjykatë në punë në regjistrin 'KZH' ka pasur 626 lëndë. Nga këto 221 lëndë janë transferuar si të pazgjidhura nga viti i mëparshëm dhe 405 lëndë janë pranuar të reja, gjegjësisht 167 lëndë më pak se vitin e kaluar. Gjithsej janë zgjidhur 590 lëndë ose 61 lëndë më shumë nga viti 2022, ndërsa si të pazgjidhura kanë ngelur 36 lëndë, gjegjësisht 185 lëndë më pak nga viti i kaluar.

Në regjistrin 'KZHM' lëndë penale në procedurë kundër të miturve, gjithsej në punë janë 17 lëndë, nga të cilat 1 ka ngelur pa u zgjidhur nga viti i kaluar dhe 16 janë pranuar si lëndë të reja. Nga këto 15 lëndë janë zgjidhur, ndërsa 2 lëndë transferohen si të pazgjidhura për vitin e ardhshëm.

Në regjistrin 'KSZH' këshilli penal janë regjistruar 138 lëndë që është ulje e 20 lëndëve në raport me vitin 2022. Së bashku me 1 lëndë të pazgjidhur nga viti i kaluar, gjithsej në punë ka pasur 139 lëndë. Në periudhën raportuese janë zgjidhur 136 lëndë, ndërsa 3 lëndë janë transferuar për vitin e ardhshëm.

Në regjistrin 'PRKZH' lëndë për kundërvajtje janë regjistruar 503 lëndë, gjegjësisht 181 lëndë më pak se viti 2022. Duke pasur parasysh 5 lëndët e pazgjidhura nga viti i mëparshëm, gjithsej në punë ka pasur 508 lëndë, nga të cilat gjatë periudhës raportuese janë zgjedhur 502 lëndë, ndërsa 6 lëndë janë transferuar si të pazgjidhura për vitin e ardhshëm.

Në regjistrin 'KR' janë regjistruar 47 lëndë që paraqet rritje prej 10 lëndëve në raport me vitin e kaluar. Bashkë me 3 lëndët e pazgjidhura nga viti i kaluar në punë ka pasur 50 lëndë. Nga këto 48 lëndë janë zgjidhur, ndërsa 2 lëndë transferohen si të pazgjidhura për vitin e ardhshëm.

Gjendja në lidhje me kohëzgjatjen e procedurës është si vijon:

- **Deri 1 muaj** janë zgjidhur 634 lëndë ose 49,11%,
- **Nga 1 deri 3 muaj** janë zgjidhur 245 lëndë ose 18,98%,
- **Nga 3 deri 6 muaj** janë zgjidhur 247 lëndë ose 19,13%,
- **Mbi 6 muaj** janë zgjidhur 165 lëndë ose 12,78%.

Regjistri	Lëndë të pazgjedhura në fillim të vitit	Lëndë të reja të pranuar	Lëndë që punohen përsëri	Gabimisht të regjistruar	Gjithsej lëndë në punë	Lëndë të zgjedhura	Lëndë të pazgjedhura
KZH	221	405	0	0	626	590	36
KZHM	1	16	0	0	17	15	2
KSZH	1	138	0	0	139	136	3
PRKZH	5	503	0	0	508	502	6
KR	3	47	0	0	50	48	2
<b>GJITHSEJ</b>	<b>231</b>	<b>1.109</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>1.340</b>	<b>1.291</b>	<b>49</b>

## B) SEKTORI CIVIL

Në sektorin civil në pajtim me orarin për punë të gjykatësve dhe të punësuarve të tjerë për vitin 2023, kanë qenë ky këshilla të cilat veprojnë me lëndët e regjistruara në regjistrin 'GZH' lëndë civile të shkallës së dytë dhe këshilli i tretë i cili vepron me lëndët për konestetet tregtare dhe të punës në regjistrin 'TSZH' lëndë të kontesteve të tregtisë të shkallës së dytë dhe në regjistrin 'ROZH' lëndë të kontesteve të punës. Në korniza të sektorit civil ka edhe në këshill të posaçëm që vepron me lëndët P5 – vërtetim i përgjegjesisë civile për fyerje dhe sharje, gjithashtu ka edhe një këshill të posaçëm që punon me lëndët për falimentim.

Në sektorin civil në periudhën raportuese gjithsej në punë ka pasur 2.529 lëndë civile, nga të cilët 710 lëndë janë transferuar si të pazgjidhura nga viti i kaluar dhe 1.819 lëndë janë pranuar të reja, me çka gjykata gjithsej ka zgjidhur 1.930 lëndë, ndërsa në fund të vitit të pazgjidhura kanë ngelur 599 lëndë të tranferohen për vitin e ardhshëm.

Në lidhje me vitin e mëparshëm, kur gjykata ka pasur gjithsej 2.186 lëndë të pranuar, fluksi i punës në periudhën raportuese është zvogëluar për 367 lëndë dhe numri është 1.819 lëndë. Zvogëlimi i lëndëve të pranuar vërehet në të gjitha regjistrat e këtij sektori.

Në lidhje me lëndët e zgjidhura, në vitin 2022 janë zgjidhur gjithsej 1.958 lëndë, ndërsa në vitin 2023 ky numër është zvogëluar për 28 lëndë dhe numri është 1.930 lëndë. Në fund të vitit në punë të pazgjidhura kanë ngelur 599 lëndë, gjegjësisht 111 lëndë më pak nga viti 2022.

Në regjistrin 'GZH' lëndë civile, të regjistruara kanë qenë 1.031 lëndë, që është zvogëlimi i 252 lëndëve në lidhje me vitin e kaluar. Duke pasur parasysh 486 lëndët nga viti i mëparshëm, gjithsej në punë ka pasur 1.517 lëndë. Numri i lëndëve të zgjidhura është 1.134 lëndë, gjegjësisht 50 lëndë më shumë nga viti 2022, ndërsa të pazgjidhura kanë ngelur 383 lëndë që transferohen në vitin e ardhshëm.

Në regjistrin 'TSZH' konteste tregtare, janë regjistruar 127 lëndë ose 20 lëndë më pak se viti 2022, dhe duke pasur parasysh 21 lëndët e pazgjidhura nga viti i mëparshëm, gjithsej në punë ka pasur 148 lëndë. Nga këto janë zgjidhur 106 lëndë, ndërsa të pazgjidhura kanë ngelur 42 lëndë.

Në regjistrin 'ROZH' konteste të punës janë zgjidhur 614 lëndë që paraqet zvogëlim të 65 lëndëve në raport me vitin e kaluar. Duke pasur parasysh 202 lëndët e pazgjidhura nga viti i mëparshëm, gjithsej në punë ka pasur 816 lëndë. Nga këto gjatë periudhës raportuese janë zgjidhur 642 lëndë, ndërsa si të pazgjidhura kanë ngelur 174 lëndë ose 28 lëndë më pak se viti 2022.

Në regjistrin 'R' lëndë të ndryshme civile, është vërtetuar ulje e 30 lëndëve në raport me vitin e kaluar, gjegjësisht janë pranuar 47 lëndë. Duke pasur parasysh 1 lëndë të pazgjidhur nga viti i mëparshëm, gjithsej në punë ka pasur 48 lëndë dhe të njejtat janë kryer gjatë periudhës raportuese.

Këshilli që punon në vërtetimin e përgjegjesisë civile për fyerje dhe sharje në periudhën raportuese në punë ka pasur 13 lëndë, nga të cilat 8 janë të pazgjidhura nga viti i mëparshëm dhe 5 janë të pranuar si lëndë të reja. Të gjitha këto lëndë janë zgjidhur në periudhën raportuese. Në vitin 2023 nuk ka lëndë të regjistruara në lidhje me falimentim.

Gjendja në lidhje me kohëzgjatjen e procedurës është si vijon:

- **Deri 1 muaj** janë zgjidhur 322 lëndë ose 16,68%,
- **Nga 1 deri 3 muaj** janë zgjidhur 351 lëndë ose 18,19%,
- **Nga 3 deri 6 muaj** janë zgjidhur 709 lëndë ose 36,74%,
- **Mbi 6 muaj** janë zgjidhur 548 lëndë ose 28,39%.

Regjistri	Lëndë të pazgjedhura në fillim të vitit	Lëndë të reja të pranuar	Lëndë që punohen përsëri	Gabimisht të regjistruara	Gjithsej lëndë në punë	Lëndë të zgjedhura	Lëndë të pazgjedhura
GZH	486	1031	0	0	1517	1134	383
ROZH	202	614	0	0	816	642	174
TSZH	21	127	0	0	148	106	42
R	1	47	0	0	48	48	0
<b>GJITHSEJ</b>	<b>710</b>	<b>1.819</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>2.529</b>	<b>1.930</b>	<b>599</b>

## 5. KUALITETI I LËNDËVE NË NIVEL TË SEKTORIT

### A) SEKTORI PENAL

Sektori penal i Gjykatës së Apelit Gostivar në periudhën raportuese e ka mbajtur kualitetin e lartë të punës, sipas të dhënave nga lëndët e kthyer nga ana e Gjykatës Supreme.

Në periudhën raportuese gjithsej janë kthyer 32 vendime për lëndët penale. Nga këto 25 vendime janë **vërtetuar** gjegjësisht 1,94% nga gjithsej lëndë të zgjedhura dhe 7 vendime janë **anuluar** gjegjësisht 0,54% nga gjithsej lëndë të zgjedhura në këtë sektor.

Në regjistrin 'KZH' janë vërtetuar 21 vendime gjegjësisht 3,56% nga gjithsej lëndë të zgjedhura dhe 7 vendime janë anuluar gjegjësisht 1,19% nga gjithsej lëndë të zgjedhura në këtë regjistër.

Në regjistrin 'KSZH' janë kthyer 4 vendime, të njejtat janë vërtetuar gjegjësisht 2,94% nga gjithsej lëndë të zgjedhura në këtë regjistër.

Regjistri	Lëndë të dërguara		Të vërtetuara		Të anuluar		Të ndryshuara	
KZH	590		21	3,56%	7	1,19%	0	0
KZHM	15		0	0	0	0	0	0
KSZH	136		4	2,94%	0	0	0	0
PRKZH	502		0	0	0	0	0	0
KR	48		0	0	0	0	0	0
<b>GJITHSEJ</b>	<b>1.291</b>		<b>25</b>	<b>1,94%</b>	<b>7</b>	<b>0,54%</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

Në lidhje me 32 lëndët e kthyer nga Gjykata Supreme, janë vërtetuar 78,13% nga numri i lëndëve që kanë qenë jashtë mjetit të zakonshëm juridik dhe janë anuluar 21,87% nga numri i lëndëve që kanë qenë jashtë mjetit të zakonshëm juridik.



Në regjistrin 'KZH' nga gjithsej 28 vendime, janë vërtetuar 21 vendime gjegjësisht 75% nga numri i lëndëve jashtë mjetit të zakonshëm juridik dhe 7 vendime janë anuluar gjegjësisht 25% nga numri i lëndëve që janë jashtë mjetit të zakonshëm juridik.

Në regjistrin 'KSZH', 4 vendime janë vërtetuar gjegjësisht 100% e numrit të lëndëve të cilat kanë qenë jashtë mjetit të zakonshëm juridik.

Regjistri	Vendime sipas MJJ	Të vërtetuara		Të anuluar		Të ndryshuara	
KZH	28	21	75%	7	25%	0	0
KZHM	0	0	0	0	0	0	0
KSZH	4	4	100%	0	0	0	0
PRKZH	0	0	0	0	0	0	0
KR	0	0	0	0	0	0	0
<b>GJITHSEJ</b>	<b>32</b>	<b>25</b>	<b>78,13%</b>	<b>7</b>	<b>21,87%</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

#### B) SEKTORI CIVIL

Sektori civil i Gjykatës së Apelit Gostivar në periudhën raportuese sipas të dhënave nga lëndët e kthyer nga ana e Gjykatës Supreme, ka mbajtur kualitetin e lartë të punës.

Në periudhën raportuese nga Gjykata Supreme janë kthyer 61 vendime, nga to 45 janë **vërtetuar** gjegjësisht 2,33% nga gjithsej lëndë të zgjidhura, 6 vendime janë **ndryshuar** gjegjësisht 0,31% nga gjithsej lëndë të zgjidhura dhe 10 vendime janë **anuluar** gjegjësisht 0,52% nga gjithsej lëndë të zgjidhura në këtë sektor.

Në regjistrin 'GZH' janë vërtetuar 30 lëndë gjegjësisht 2,65% nga gjithsej lëndë të zgjidhura, 3 vendime janë ndryshuar gjegjësisht 0,26% nga gjithsej lëndë të zgjidhura dhe 9 vendime janë anuluar gjegjësisht 0,79% nga gjithsej lëndë të zgjidhura në këtë regjistër.

Në regjistrin 'TSZH' janë vërtetuar 5 vendime gjegjësisht 4,72% nga gjithsej lëndë të zgjidhura, 3 vendime janë ndryshuar gjegjësisht 2,83% nga gjithsej lëndë të zgjidhura dhe 1 vendim është anuluar gjegjësisht 0,94% nga gjithsej lëndë të zgjidhura në këtë regjistër.

Në regjistrin 'ROZH' janë vërtetuar 10 vendime gjegjësisht 1,56% nga gjithsej lëndë të zgjidhura.

Regjistri	Lëndë të zgjidhura	Të vërtetuara		Të ndryshuara		Të anuluar	
GZH	1.134	30	2,65%	3	0,26%	9	0,79%
TSZH	106	5	4,72%	3	2,83%	1	0,94%
ROZH	642	10	1,56%	0	0	0	0
R	48	0	0	0	0	0	0
<b>GJITHSEJ</b>	<b>1.930</b>	<b>45</b>	<b>2,33%</b>	<b>6</b>	<b>0,31%</b>	<b>10</b>	<b>0,52%</b>

Në lidhje me 61 vendime të kthyera nga Gjykata Supreme, janë vërtetuar 73,77% nga lëndët që kanë qenë jashtë mjetit të zakonshëm juridik, janë anuluar 16,39% vendime nga numri i lëndëve që kanë qenë jashtë mjetit të zakonshëm juridik dhe janë ndryshuar 9,84% nga numri i lëndëve të cilat kanë qenë jashtë mjetit të zakonshëm juridik.

Në regjistrin 'GZH' nga 42 vendimet e kthyera, janë vërtetuar 30 lëndë gjegjësisht 71,43% nga numri i lëndëve që kanë qenë jashtë mjetit të zakonshëm juridik, 3 vendime janë ndryshuar gjegjësisht 7,14% nga numri i lëndëve që kanë qenë jashtë mjetit të zakonshëm juridik dhe 9 vendime janë anuluar gjegjësisht 21,43% nga numri i lëndëve që kanë qenë jashtë mjetit të zakonshëm juridik.

Në regjistrin 'TSZH' nga 9 vendimet e kthyera janë vërtetuar 5 vendime gjegjësisht 55,56% nga numri i lëndëve të cilat kanë qenë jashtë mjetit të zakonshëm juridik, 3 vendime janë ndryshuar gjegjësisht 33,33% nga numri i lëndëve të cilat kanë qenë jashtë mjetit të zakonshëm juridik dhe 1 vendim është anuluar gjegjësisht 11,11% nga numri i lëndëve të cilat kanë qenë jashtë mjetit të zakonshëm juridik.

Në regjistrin 'ROZH' nga 10 lëndët e kthyera të gjitha janë të vërtetuara gjegjësisht 100% e numrit të lëndëve të cilat kanë qenë jashtë mjetit të zakonshëm juridik.

Regjistri	Vendime sipas MJJ	Të vërtetuara		Të ndryshuara		Të anuluar	
GZH	42	30	71,43%	3	7,14%	9	21,43%
TSZH	9	5	55,56%	3	33,33%	1	11,11%
ROZH	10	10	100%	0	0	0	0
R	0	0	0	0	0	0	0
<b>GJITHSEJ</b>	<b>61</b>	<b>45</b>	<b>73,77%</b>	<b>6</b>	<b>9,84%</b>	<b>10</b>	<b>16,39%</b>

## 6. GJENDJA ME LËNDËT E VJETRA

Si lëndë të vjetra në këtë periudhë raportuese, gjithsej në punë ka pasur 879 lëndë, nga të cilat 168 lëndë janë transferuar si lëndë të vjetra të pazgjdhura nga viti i mëparshëm dhe 711 lëndë janë pranuar si të reja, gjegjësisht iu ka kaluar periudha prej 6 muaj nga dita e pranimit të lëndës në gjyq. Nga këto janë zgjidhur gjithsej 684 lëndë, ndërsa në fund të vitit kanë ngelur 195 lëndë të pazgjdhura të cilat transferohen në vitin e ardhshëm.

Regjistri	Lëndë të vjetra të pazgjdhura	Lëndë të teja të pranuar por të vjetra	Gjithsej në punë lëndë të vjetra	Lëndë të vjetra të zgjidhura	Mbetja e lëndëve të vjetra
KZH	67	100	167	159	8
KSZH	0	1	1	1	0
KZHM	0	1	1	1	0
PRKZH	0	1	1	1	0
GZH	100	542	642	474	168
ROZH	1	45	46	37	9
TSZH	0	21	21	11	10
<b>GJITHSEJ</b>	<b>168</b>	<b>711</b>	<b>879</b>	<b>684</b>	<b>195</b>

## 7. RAPORT PËR RESURSET NJERËZORE

### POZICIONET ORGANIZUESE

Në pajtim me rregulloren gjyqësore Gjykata e Apelit Gostivar kompetencat e saj i realizon përmes zyrës së kryetarit të gjykatës, sektorit penal, sektorit civil, sektorit për praktikë gjyqësore, sekretarinë e gjykatës dhe zyrës për marrëdhënie me publikun.

Në korniza të zyrës së kryetarit të gjyqit punuan: udhëheqësi i sektorit për praktikë gjyqësore, udhëheqësi i sektorit të informatikës, referenti i pavarur – kontabilist dhe referenti i pavarur gjyqësor – kordinator i daktilografisë. Udhëheqësi i sektorit për praktikë gjyqësore kompetencën e tij e realizon vet dhe me ndihmën e të punësuarve të tjerë në zyrën e kryetarit të gjykatës.

Në sektorin penal deri në maj të vitit 2023 kanë qenë të shpërndarë 4 gjykatës përfshi edhe kryetarin e gjyqit, ku në muajin maj 2023 u zgjodhën dy gjykatës penal, ndërsa në muajin tetor të vitit 2023 në gjykatës nga sektori penal u pensionua, 1 (një) udhëheqës i sektorit penal, 3 (tre) këshilltar gjyqësor, 2 (dy) bashkëpunëtor profesional dhe 1 (një) bashkëpunëtor i ri gjyqësor.

Në sektorin civil kanë qenë të shpërndarë 7 gjykatës, 1 (një) udhëheqës i sektorit civil, 2 (dy) udhëheqës të seksioneve, 1 (një) këshilltar gjyqësor, 1 (një) këshilltar, 1 (një) bashkëpunëtor profesional dhe 2 (dy) bashkëpunëtor të ri profesional.

Në sektorin e praktikës gjyqësore kanë qenë të shpërndarë 3 gjykatës dhe atë: kryetari i sektorit, kryetari i sektorit penal dhe kryetari i sektorit civil, udhëheqësi i sektorit për praktikë gjyqësore dhe 1 (një) këshilltar.

Në sekretarinë gjyqësore kanë qenë të shpërndarë 1 (një) udhëheqës i sekretarisë, 3 (tre) regjistruar të sekretarisë në sektorin penal dhe 1 – një referent për pranim dhe ekspeditim të postës dhe arhivues.

### SISTEMATIZIMI

Në pajtim me vendimin e Këshillit Gjyqësor të RM nr.07-1103/1 nga data 04.06.2012, në Gjykatën e Apelit Gostivar janë paraparë 16 gjykatës së bashku me kryetarin e gjyqit, janë mbushur 12 vende për gjykatës dhe 4 janë të zbrazura, nga të cilët një vend për gjykatës është në pushim për shkak se një gjykatës është anëtarë i Këshillit Gjyqësor të RMV.

Në pajtim me aktin e sistematizimit të kësaj gjykate SU.nr/AGJ.nr.0101-3/22 nga data 16.03.2022, janë të paraparë 134 vende pune dhe atë: 115 nëpunës gjyqësor, 8 polic gjyqësor dhe 11 vende pune për personel teknik sipas Ligjit për marrëdhënie pune, nga të cilët 37 janë përmbushur ndërsa ngelin vende të zbrazura edhe 97.

Në Gjykatën e Apelit Gostivar struktura momentale e të punësuarve është si vijon:

**Kategoria 'B'** – 1 (një) udhëheqës i sektorit penal, 1 (një) udhëheqës i sektorit civil, 1 (një) udhëheqës i sektorit për praktikë gjyqësore, 1 (një) udhëheqës i seksionit – për marrëdhënie me publikun dhe analitikë, 1 (një) udhëheqës i sektorit për burime njerëzore dhe 1 (një) udhëheqës i sektorit të informatikës.

**Kategoria 'V'** – 4 (katër) këshilltar gjyqësor, 1 (një) këshilltar për prokurime publike, 2 (dy) këshilltar – përkthyes, 3 (tre) bashkëpunëtor gjyqësor, 5 (pesë) bashkëpunëtor të ri gjyqësor, 1 (një) bashkëpunëtor i ri – përkthyes dhe 1 (një) bashkëpunëtor i ri – ekonomist.

**Kategoria 'G'** – 1 (një) referent i pavarur gjyqësor – udhëheqës i sekretarisë së sektorit civil, 3 (tre) referent të pavarur gjyqësor - udhëheqës të regjistrave, 1 (një) referent i pavarur - koordinator i daktilografisë, 1 (një) referent i pavarur - kontabilist, 5 (pesë) referent gjyqësor - daktilograf dhe 1 (një) referent i ri – kryerja e punëve administrative teknike.

**Të punësuar sipas LMP** – 1 (një) vozitës dhe 1 (një) pastrues.

Nga gjithsej vendet e parapara sipas sistematizimit të Gjykatës së Apelit Gostivar, vende të zbrazura janë si vijon:

**Kategoria 'A'** – 1 (një) administrator gjyqësor.

**Kategoria 'B'** – nëpunës udhëheqës gjyqësor nga vendet e parapara prej 10 vendeve, të papërbushura janë 4 dhe atë: 1 (një) nëpunës gjyqësor i pavarur, 1 (një) udhëheqës i shërbimit juridik profesional, 1 (një) udhëheqës ndihmës i shërbimit profesional dhe 1 (një) udhëheqës i sektorit për punë finansiare dhe materiale.

**Kategoria 'V'** – nëpunës gjyqësor profesional, nga 58 vendet e parapara, të papërbushura janë 41 dhe atë: 12 (dymbëdhjetë) këshilltar gjyqësor, 2 (dy) këshilltar informatik, 1 (një) këshilltar për punë finansiare dhe materiale, 1 (një) këshilltar – zëdhënës, 3 (tre) këshilltar lektor, 5 (pesë) bashkëpunëtor të lartë gjyqësor, 1 (një) bashkëpunëtor i lartë gjyqësor – analist i ndjekjes së punës së praktikës gjyqësore, 7 (shtatë) bashkëpunëtor gjyqësor, 1 (një) bashkëpunëtor – përkthyes interpretues, 1 (një) bashkëpunëtor për siguri në punë dhe 5 (pesë) bashkëpunëtor të ri gjyqësor.

**Kategoria 'G'** – nëpunës gjyqësor ndihmës, nga 46 vendet e parapara, të papërbushura janë 34 dhe atë: 1 (një) referent i pavarur gjyqësor - sekretar teknik i kryetarit të gjykatës, 1 (një) referent i pavarur gjyqësor - sekretar teknik i administratorit gjyqësor, 1 (një) referent i pavarur gjyqësor - udhëheqës i sekretarisë në sektorin penal, 1 (një) referent i pavarur gjyqësor - udhëheqës i regjistratit, 1 (një) referent i pavarur gjyqësor për praninë dhe ekspeditim të postës, 1 (një) referent i pavarur informatik, 1 (një) referent i pavarur - udhëheqës i librisë profesionale, 4 (katër) referent të lartë gjyqësor - përmbarues të sekretarisë gjyqësore, 7 (shtatë) referent të lartë gjyqësor - daktilograf, 1 (një) referent i lartë në sektorin për resurse njerëzore - udhëheqës i objektit të gjyqit, 6 (gjashtë) referent gjyqësor - daktilograf, 1 (një) referent gjyqësor – shpërndarës, 3 (tre) referent të ri gjyqësor – përmbarues në sekretarinë gjyqësore dhe 2 (dy) referent të ri – përmbarues i punëve administrative teknike.

**Policia Gjyqësore** – nga 8 vendet e parapara, të papërbushura janë 8 vende dhe atë: 1 (një) koordinator i policisë gjyqësore, 1 (një) komandant i policisë gjyqësore dhe 6 (gjashtë) pjesëtar të policisë.

**Të punësuar sipas LMP** – nga 11 vendet e parapara të papërbushur janë 9 vende dhe atë: 1 (një) operator i centralit telefonik, 1 (një) kujdestar i shtëpisë, 1 (një) korrier, 2 (dy) punëtor në bifenë gjyqësore dhe 4 (katër) pastrues.

#### FUNKSIONIN E GJYKATËSVE

Në pajtim me vendimin e Këshillit Gjyqësor të RM nr.07-1103/1 nga data 04.06.2012, funksionin gjyqësor në Gjykatën e Apelit Gostivar është e vërtetuar që ta kryejnë 16 gjykatës përfshi edhe kryetarin e gjykatës, megjithatë, gjatë periudhës raportuese, gjykata funksionoi me numër të papërbushur të gjykatësve, me atë që funksionin e gjykatësve deri në muajin 2023 e kryejtën 11 gjykatës përfshi edhe kryetarin e gjykatës, ku në muajin maj të vitin 2023 u zgjodhën 2 gjykatës të

sektorit penal, ndërsa në muajin tetor 2023 një gjykatës u pensionua. Vitin 2023 gjykata e përfundoi me 12 gjykatës përfshi edhe kryetarin e gjykatës. Në këtë vit gjykata u ballafaqua me pengesa gjatë efikasitetit të punës dhe përditësimit për zotërimin e fluksit të lëndëve në varshmëri nga fluksi i lëndëve të reja të pranuar. Ky problem pritet të thellohet edhe gjatë vitit 2024 deri sa nuk merren masa për zgjedhje të gjykatësve të rinj.

#### SHËRBIMI GJYQËSOR

Nëpunësit gjyqësor profesional gjatë periudhës raportuese kanë pasur kontribut të veçantë në funksionimin e gjykatës përmes kryerjes së detyrave në mënyrë profesionale dhe të ndërgjegjshme, në lidhje me përpunimin e vendimeve gjyqësore dhe punëve të tjera.

Në pajtim me përmbushjen e vendeve të punës sipas Aktit të Sistematizimit në këtë gjykatë, në periudhën raportuese 2023 gjendja është si vijon: gjithsej 37 nëpunës gjyqësor dhe 2 teknik personal dhe atë: 1 udhëheqës i sektorit penal, 1 udhëheqës i sektorit civil, 1 udhëheqës i sektorit për praktikë gjyqësore, 1 udhëheqës i seksionit për marrëdhënie me publikun dhe analitikë, 1 udhëheqës i seksionit për resurse njerëzore, 1 udhëheqës i sektorit të informatikës, 4 këshilltar gjyqësor, 1 këshilltar për prokurime publike, 2 këshilltar përkthyes, 3 bashkpunëtor gjyqësor, 5 bashkpunëtor të ri gjyqësor, 1 bashkpunëtor i ri përkthyes, 1 bashkpunëtor i ri ekonomist, 1 referent i pavarur udhëheqës i sekretarisë gjyqësore sektori civil, 1 referent i pavarur udhëheqës i regjistrin në sektorin penal, 1 referent i pavarur kordinator i daktilografisë, 1 referent i pavarur – kontabilist, 1 referent i ri përmbarues i punëve administrativo teknike, 5 referent gjyqësor daktilograf, 1 vozitës dhe 1 pastrues.

Gjykata udhëheq pa administator gjyqësor, ndërsa punët e administratorit gjyqësor i kryen udhëheqësi i sektorit për praktikë gjyqësore, gjithashtu gjykata nuk ka të punësuar pjesëtar të policisë gjyqësore.

Gjatë periudhës 2023, Gjykata e Apelit Gostivar përmes shpalljes publike ka bërë një punësim të ri dhe atë: 1 referent gjyqësor daktilograf, përmes marrjes së përhershme nga Ministria për sistem politik dhe raporte në mes komuniteteve 2 nëpunës gjyqësor me tituj: 1 bashkpunëtor i ri gjyqësor dhe 1 bashkpunëtor i ri përkthyes dhe përmes konkursit të brendshëm janë realizuar 10 avansime në karrierë me titujt 1 udhëheqës i sektorit penal, 1 udhëheqës i sektorit civil, 1 udhëheqës i seksionit gjyqësor për marrëdhënie me publikun dhe analitikë, 1 udhëheqës i seksionit për resurse njerëzore, 3 këshilltar gjyqësor, 1 këshilltar për prokurime publike dhe 2 këshilltar përkthyes.

Gjatë vitit 2023 në Gjykatën e Apelit Gostivar marrëdhëniet e punës u janë ndërprerë 2 të punësuarve dhe atë: 1 referenti gjyqësor daktilograf dhe 1 pastrues.

Gjykata e Apelit Gostivar për të arritur efikasitetin maksimal në punën e të gjitha sektorëve dhe fushave, gjegjësisht që të kryhen punët në mënyrë kualitative dhe profesionale dhe të arrihen qëllimet në korniza të kompetencave të kësaj gjykate, duhet të ketë punësime të reja të kuadrit profesional personelit administrativo teknik, si dhe të punësohen polic gjyqësor.

#### VLERËSIMI I SIGURISË SË TË PUNËSUARVE, PALËVE, LËNDËVE DHE PAJISJA E GJYKATËS SIPAS STANDARDEVE

Gjendja e sigurisë së të punësuarve, palëve, lëndëve dhe pajisjeve të gjykatës është në nivel të kënaqur. Gjykata është e pajisur tërësisht me video vrojtimit ashtu që janë vendosur 4 kamera në të

gjitha vendet më të rëndësishme në hapësirat e gjykatës, ndërsa jashtë gjykatës janë të vendosura kamera në Gjykatën Themelore Gostivar. Në Gjykatën e Apelit Gostivar nuk ka të punësuar pjesëtar të policisë gjyqësore, sigurinë e të punësuarve, ndërtesës gjyqësore dhe palëve e kryen policia gjyqësore e Gjykatës Themelore Gostivar që japin kontribut të madh për sigurinë.

Në pajtim me planin e prokurimeve publike për vitin 2023, ndërsa përmes shpalljes së tenderëve për prokurime publike janë 14 kompjuterë të cilët janë shpërnda te të gjithë të punësuarit, me atë që të gjithë të punësuarit kanë kompjuter të ri.

Lëndët e gjykatës pranohen në sekretarinë gjyqësore e cila është e pajisur me dollap të mëdhenj dhe të gjatë dhe dollap prej metali ku ruhen lëndët, të cilat mbyllen, dhe gjithashtu edhe gjykatësit në zyrat e tyre kanë dollap në të cilët i ruajnë lëndët dhe i mbyllin. Zyrat e të punësuarve të tjerë gjithashtu janë të pajisura me mjetet e domosdoshme dhe të nevojshme – dollap, tavolina, karrige, kompjuterë.

Gjykata në rast të zjarrit është e pajisur me numër të madh të aparatave PP në pajtim me hapësirën e objektit dhe ngarkesën e zjarrit dhe atë 7 aparate kundër zjarrit, të cilat kontrollohen rregullisht nga persona të specializuar që kanë autorizim të dhënë nga Drejtoria për mbrojtje dhe shpëtim, gjithashtu gjykata është e pajisur me rrjet hidranti për shuarje të zjarrit, ka të vendosur dollap me hidrant me shtypje prej 7 bar, një zorrë dhe një lidhje metalike.

Në fillim të vitit 2017 Gjykata e Apelit Gostivar mori çertifikatën për standardin e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015. Në pajtim me këtë standard janë hartuar procedura me zbatimin e të cilave mundësohet sigurimi i të dhënave, lëndëve dhe pajisjeve IT në gjykatë, ndërsa më datë 14.12.2023 është bërë ricertifikim i çertifikatës për standardin e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015.

Gjykata e Apelit Gostivar kryen përpunim elektronik të të dhënave në sistemin informatik që paraqet përbërje të serverit, pajisje për rrjetin, kompjuterë personal, printues, media portative dhe mjete të softuerit si mbështetje e sistemit infomatik.

Sipas procedurës për shpërndarje të privilegjeve të përdoruesit për autorizimin e personave që përpunojnë të dhënat personale në bazë të aktit të sistematizimit dhe orarit të punës, secili punonjës caktohet në një grup të përshtatshëm përdoruesish me privilegje të përcaktuara saktë për qasje në sistemin AKMIS dhe të dhëna të tjera në sistemin informatik. Me procedurën Rregullat për qasje në dhomën e serverit, është paraparë regjistrimi i hyrjes në dhomën e serverit për të siguruar: kontroll mbi hyrjen dhe daljen nga dhoma ku janë të vendosur serverët dhe mbrojtjen dhe sigurinë e të dhënave të përpunuara në Gjykatën e Apelit Gostivar.

Gjykata e Apelit Gostivar vendos dhe praktikon masa për siguri fizike të sistemeve informatike për sigurimit fizik të hapësirave të punës dhe mjeteve informatike – komunikative ku mblidhen, rruhen dhe përpunohen të dhënat. Qasje në hapësirat ku janë pajisjet informatike – komunikative ka udhëheqësi i sektorit për informatikë dhe personat e tjerë të autorizuar nga ana e kryetarit të gjykatës. Qasje fizike në hapësirën ku është vendosur server ka administrator i sistemit informatik, i cili është i autorizuar me shkrim nga ana e kryetarit të gjykatës, me saktësim të rolit të tij dhe me arsyetim të arsyeve, gjegjësisht nevojës për dhënie të autorizimit për qasje. Person tjetër mund të merr autorizim për dhomën e serverit vetëm me aktvendim për qasje në dhomën e serverit të lëshuar nga kryetari i gjykatës. Që të sigurohet sistemi informatik hapësira e serverit i përmbush kushtet optimale, është e kondicionuar dhe nuk ka trupa ngrohës, ka sistem ftohës që ruan temperaturën dhe lagështinë konstante, hyrja në këtë hapësirë është e siguruar me kamerë. Dera e hapësirës mbahet e mbyllur me çels dhe atë çels e mban nëpunësi gjyqësor – udhëheqës i sektorit të informatikës.

Me procedurat Sigurim fizik dhe kontroll me video dhe evidencë të personave të hyjnë në gjykatë vendoset mënyra e kryerjes së kontrollit me video në hapësirat e gjykatës, si dhe mënyrën e evidentimit të personave të cilat hyjnë në gjykatë, me qëllim që të sigurohet: sigurimi i pronës, sigurimi i jetës dhe shëndetit të të punësuarve dhe personave që janë të pranishëm në gjykata për shkak të natyrës së punës dhe kontrollit të hyrjes dhe daljes nga hapësirat zyrtare dhe të punës. Regjistrimet e kamerave rruhen në hard diskun e sistemit për vrojtim me video i cili ndodhet në zyrë të posaçme.

Për hyrje dhe dalje në gjykatë, të punësuarit dhe palët e shfrytëzojnë të njejtën hyrje (të vetmen), kontrollin e hyrjes dhe daljes së personave në ndërtesën e gjykatës e bëjnë policia gjyqësore e Gjykatës Themelore Gostivar.

#### **8. RAPORT PËR HARMONIZIM TË PRAKTIKËS GJYQËSORE**

Këtë sektor e përbëjnë Kryetari i sektorit – gjykatës, kryetarët e sektorit penal dhe civil, udhëheqësi i sektorit për praktikë gjyqësore dhe një këshilltar. Sektori për praktike gjyqësore, çdo vit sjell plan vjetor për kryerjen e punëve në kompetenca të tij. Në vitin 2023, sektori për praktikë gjyqësore i kryejti punët në kompetenca të tij.

Në seancat e mbajtura të sektorit penal, civil dhe sektorit për praktikë gjyqësore në Gjykatën e Apelit Gostivar në vitin 2023 janë shqyrtuar më shumë pyetje profesionale me qëllim të harmonizimit të praktikës gjyqësore dhe janë shqyrtuar edhe pyetjet juridike të përgaditura nga ana e gjykatësve të kësaj gjykate dhe pyetjeve juridike të dorëzuara nga të gjithë gjykatat e apelit me qëllim të mbajtjes së mbledhjes së përbashkët të të gjithë gjykatësve nga 4 gjykatat e apelit në RMV.

Gjatë vitit 2023 nga ana e Akademisë për gjykatës dhe prokuror publik të RMV, është organizuar edhe tavolinë e rrumbullakët në nivel të Gjykatës Supreme të RMV dhe katër Gjykatave të Apelit të RMV, për harmonizimin e praktikës gjyqësore ku janë sjellë përfundime të disa pyetjeve të caktuara.

#### **9. RAPORT PËR VIZITAT E KRYERA TË GJYKATAVE MË TË ULTA**

Në bazë të metodologjisë për kryerje të vizitave të punës në gjykatat themelore nga rajoni i Gjykatës së Apelit Gostivar dhe orarin e vërtetuar të vizitave të punës në Gjykatat Themelore nga ky rajon i apelit për vitin 2023, gjykata gjatë periudhës raportuese kryejti një vizitë punë, gjegjësisht vizita ishte e organizuar dhe e realizuar gjatë muajit shtator dhe tetor të vitin 2023. U formuan grupe nga gjykatësit e Gjykatës së Apelit Gostivar. Më parë u përgadit orari i kryerjes së vizitave të punës.

Kryetari i Gjykatës së Apelit Gostivar gjatë kryerjes së vizitave të punës në gjykata themelore kryejti edhe kontrollë të punës në gjykatat themelore në aspekt të zbatimit të Rregullores gjyqësore dhe kontrollit në pjesën e punës në sistemin AKMIS, në pajtim me nenin 25 nga Rregullorja gjyqësore.

Para kryerjes së vizitave të punës, të gjithë gjykatësit nga sektori penal dhe civil pranë Gjykatës së Apelit Gostivar u udhëzuan me njoftim me shkrim, gjatë kontrollit të gjykatave themelore në të cilat duhet të kenë kujdes dhe atë: kur për herë të parë është regjistruar lënda gjyqësore në gjykatën themelore, për cilën vepër penale, gjegjësisht baza e lëndës civile, cila është rrjedha e procedurës në lëndën gjyqësore, nëse aktgjykimi i shkallës së parë është anuluar dhe sa herë, nëse është sjellë mjet i jashtëm juridik në Gjykatën Supreme të RMV, dhe cilat janë arsyt për zvarritje të procedurës në lëndën gjyqësore, kur bëhet fjalë për lëndë të vjetra dhe të pambaruara, dhënia e ndihmës juridike

për pyetje të posaçme juridike të gjykatësve në gjykatat themelore në kuptim të tejkalimit të disa pengesave dhe dobësive në zgjidhjen e lëndëve, të dhënat për dërgesat elektronike, anonimizimi dhe shpallja e vendimeve në faqen zyrtare të gjykatës.

Për vizitat e kryera dhe veprimet e ndërmarra gjatë vizitave, çdo gjykatës përgaditi raport në afat prej 8 ditësh nga kontrolli i kryer, që janë dorëzuar deri në gjykatat themelore, Këshillin Gjyqësor të RMV, Gjykatën Supreme të RMV dhe Ministrisë së drejtësisë të RMV.

Nga vizitat e kryera në të gjitha gjykatat themelore në rajonin e Gjykatës së Apelit Gostivar në saje të punës së kryetarëve të gjykatave dhe gjykatave themelore në tërësi u konstatua gjendja e mëposhtme:

Shpërndarja automatike e lëndëve në gjykatat themelore kryhet nëpërmjet sistemit kompjuterik të automatizuar për administrim të lëndëve gjyqësore, gjatë ditës një here në ditë dhe atë në ora 14:00 dhe me këtë sigurohet që çdo gjykatës në gjyq të merr në punë numër të njejtë të lëndëve në pajtim me kriteret e definuara të trupit punues për standardizim në Gjykatën Supreme të RMV.

Gjatë vizitave të kryera të gjykatave themelore është vërtetuar se drejtësisht zbatohet neni 169 nga Rregullorja gjyqësore në lidhje me regjistrimin e drejtë të shkresave nga lëndët civile dhe penale, ngjijtjen kronologjike të shkresave, me ngjyrë të kuqe, numërimin e shkresave në pjesën e djathtë lartë.

Dorëzimin e lëndëve dhe shkresave nga sekretaria gjyqësore, nëpunësit gjyqësor e kryejnë në pajtim me sistemin kompjuterik të automatizuar për administrim të lëndëve gjyqësore.

Trupat punues për administrim dhe lëvizje të lëndëve në gjykata drejtësisht e kryejnë punën e tyre në pajtim me Ligjin për administrim dhe lëvizje të lëndëve në gjykata.

Gjykatësit e gjykatave themelore në deklaratat e tyre dhe njoftimet i njoftojnë kryetarët e gjykatave themelore për arsyet për të cilat nuk janë mbaruar lëndët e vjetra të pazgjidhura.

Në të gjitha gjykatat themelore janë përgaditur orare për punë për vitin 2023, orare të cilat respektohen dhe gjykatësit punojnë me këto orare, aty ku ka kushte për tu formuar edhe sektorë të specializuar.

Kryetarët e gjykatave themelore përgaditin plane aksioni për zgjidhje të lëndëve të vjetra, në të cilat përfshihen edhe mendimet e gjykatësve në lidhje me periudhën kohore kur planifikohen të zgjidhen lëndët e vjetra të cilët procedura zgjat kohë më të gjatë.

Rregullisht mbahen seanca të gjykatësve në gjykatat themelore, më së paku një herë në muaj, ndërsa sipas nevojës edhe më shumë, me çka edhe mbahen procesverbale për to.

Gjatë vizitave të punës në rajonin e Gjykatës së Apelit Gostivar u vërtetua se vendet gjyqësore të planifikuara në gjykatat themelore nuk janë përmbushur në tërësi, që paraqet edhe një nga arsyet për punë normale dhe funksionim normal të gjykatave themelore dhe zgjidhjen e lëndëve gjyqësore në afatin e duhur.

Në vizitat e punës bëhen edhe biseda me të gjithë gjykatësit në lidhje me arsyet se pse nuk janë zgjidhur lëndët e vjetra dhe u janë dhënë këshilla në lidhje me mënyrën e veprimit të mëtejshëm me këto lëndë që të arrihet zgjidhje më e suksesshme dhe më efikase e lëndëve.

Gjatë kontrollit u vërtetuan edhe probleme me veprim dhe zgjidhje të një numri të madh të lëndëve të trashigimisë që gjendjen tek noterët, ku nga ana e kryetarit të Gjykatës së Apelit Gostivar



iu tha kryetarëve të gjykatave themelore që të ndërmarrin masa edhe nga ana e tyre që ndikojnë tek noterët që më shpejtë dhe në kohë t'i zgjedhin lëndët e trashëgimisë, nga arsye që këto lëndë të trashëgimisë ndodhen te noterët dhe janë të pazgjidhura ndërsa janë në evidence të gjykatave themelore si lëndë të pazgjidhura.

## **10. RAPORT PËR MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN**

### TË DHËNA PËR PUNËN E ZYRËS PËR MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN (KONTAKTE)

Në pajtim me ligjin për qasje të lirë të informacioneve me karakter publik, të gjithë personat juridik dhe fizik kanë të drejtë të qasjes së lirë të informacioneve nga karakteri publik, të cilat sillen rreth punës së gjykatës.

Këtu pranohen të gjitha shkresat e dorëzuara dhe të gjithë personat e interesuar dhe të autorizuar në lidhje me informacione për lëndë të veçanta.

Personi zyrtar për zyrën për marrëdhënie me publikun është Sedulla Memedi.

Këtu bëhet edhe skenimi elektronik i të gjitha shkresave të parashtruara qofshin me postë apo të dorëzuara personalisht.

Zyra për marrëdhënie me publikun përgjigjet në telefonatat dhe kërkesat gojore me qëllim që të infomohen qytetarët. Qytetarët infomohen personalisht ose përmes personave të autorizuar për lëndët ku janë pjesëtarë të procedurës për lëndët që merren në punë, nëse janë zgjidhur dhe nëse janë dorëzuar në gjykatat themelore.

### NUMRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE ME LIGJIN PËR QASJE TË LIRË TË INFORMACIONIT, MËNYRËS SË PARASHTRIMIT DHE PËRGJIGJES.

Në Gjykatën e Apelit Gostivar gjatë vitit 2023 u pranuar 5 (pesë) kërkesa për informacione të karakterit publik, nga të cilat 4 kërkesa u miratuan dhe u përgjigjën në afatin e duhur kohor, ndërsa 1 (një) kërkesë është refuzuar si e pabazë me aktvendim SPI.2/22 nga data 13.01.2023, në pajtim me nenin 4 dhe nenin 12 nga Ligji për mbrojtje të të dhënave personale, gjegjësisht kërkesa e informacionit nuk është informacion i karakterit publik, kundër këtij aktvendimi është parashtruar ankesë deri te Komisioni për ruajtje të të drejtës për qasje të lire të informacioneve nga karakteri publik ankesë e cila është refuzuar si e pabazë.

Personi i autorizuar për qasje të lirë në informacion nga karakteri publik për ndërmjetësim me informacionin është Aleksandar Duroski.

### NUMRI I VENDIMEVE TË SHPALLURA NË FAQEN ZYRTARE TË GJYKATËS, FAKTORËT QË NDIKOJNË NË VENDIMET E SHPALLURA

Në veb faqen zyrtare të Gjykatës së Apelit Gostivar, rregullisht shpallen informacione për publikun, raporte mujore dhe tremujore për punën e gjykatës, njoftime, shpallje, buletin, informacione, vendime etj.

Në periudhën raportuese janë shpallur 2924 vendime të anonimizuara.

Faktorët që ndikojnë në përditësimin e shpalljeve janë, problemet momentale dhe gabimet që përkohësisht paraqiten në procesin e anonimizimit të vendimeve si dhe fluksin momental të punëve të daktilografëve.

### NJOFIMET E SHPALLURA PËR PUBLIKUN, KONFERENCAT PËR SHTYP, EVENTET PUBLIKE, DITËT E HAPURA TË ORGANIZUARA NË GJYKATË

Gjatë periudhës 2023 në veb faqen zyrtare të gjykatës janë shpallur për publikun:

- raporte mujore për punën e gjykatës;
- raporte vjetore për punën e gjykatës;
- plani vjetor për punë;
- programi vjetor për punë;
- plani për ndjekje të praktikës gjyqësore;
- plan aksional për zvogëlim të lëndëve të vjetra;
- procedura të brendshme;
- shpallje publike për punësim;
- shpallje të brendshme për avansim në karrierë,
- njoftim për publikim të Buletinëve;
- të gjitha informacionet që janë në interes të publikut.

Gjatë periudhës 2023 kryetari i gjykatës ka realizuar 2 ngjarje publike me studentët e fakultetit juridik të Universitetit Shtetëror të Tetovës, ku mundësoi nga afër të njihen me funksionimin e sistemin të drejtësisë në shtet.

Gjykata e Apelit Gostivar si pjesë e sistemit të drejtësisë në RMV, me rastin e 25 tetorit, ditës ndërkombëtare të drejtësisë, çdo vit kyçet në mënyrë aktive në shënimin e kësaj dite. Në vitin raportues kanë marrë pjesë studentët e fakultetit juridik të Universitetit Ndërkombëtar të Strugës me seli në Gostivar, së bashku me profesorët e fakultetit juridik, si dhe mediat lokale dhe atë: TV2, TV Globi dhe gazeta zyrtare Gostivar – Press. Në shënimin e kësaj dite u paraqitën aktivitetet e kësaj gjykate me qëllim që qytetarët të njihen me të drejtat e tyre bazë në më shumë fusha (qasjen në drejtësi, mediator, kryerjen e aktgjykimeve gjyqësore dhe të ngjajshme).

## 11. RAPORT PËR TEKNOLOGJINË INFORMATIKE

Funksionimi i gjykatës në periudhën raportuese në saje të teknologjisë informatike u realizua pa pengesa, posaçërisht në pjesën e shfrytëzimit të Sistemit të automatizuar informatik për administrim të lëndëve gjyqësore (AKMIS).

Programi AKMIS nga ana e të punësuarve shfrytëzohet tërësisht, në të gjitha segmentet e punës. Çdo lëndë gjegjësisht akt, rregullisht regjistrohet në dosjet elektronike dhe përpunohet ashtu si duhet. Të gjitha raportet mujore, tremujore dhe vjetore gjenerohen në mënyrë elektronike. Të njëjtat këto raporte dorëzohen deri te institucionet kompetente dhe publikohen në faqen tonë zyrtare.

Në gjykatë ka një sallë gjykimesh në të cilën është instaluar pajisja për regjistrim të zërit të seancave në pajtim me Ligjin për procedurë kontestimore. Por, e njëjta nuk përdorej nga ana e gjykatësve në këtë periudhë, sepse kemi pasur problem me pajisjet dhe nuk ekzistonte mundësi për servisim ose ri-instalim i të njëjtës. Prandaj propozojmë urgjentisht të pajiset salla e gjykimeve me sistem të ri me të cilin nuk do të sigurohej vetëm regjistrimi audio por edhe regjistrimi vizuel i krijimit të procesverbaleve audio-vizuele të gjykimeve.

Në lidhje me dërgesat elektronike, në këtë periudhë raportuese nuk janë paraqitur probleme dhe ajo po realizohet pa pengesa me sistemin ‘Sistemi për dërgesa elektronike të dokumenteve gjyqësore’, vetëm ndaj atyre avokatëve të cilat regjistrohen në portalin e dërgesave elektronike. Gjatë periudhës 2023 është kryer dërgesë elektronike për 22 shkresa.

Në gjykatë, rregullisht kryhet edhe skenim i të gjitha shkresave në lidhje me lëndët gjyqësore të cilat janë dërguar drejtpërdrejtë në gjykatë dhe të njejtat bashkangjiten në dosjet elektronike të lëndëve në AKMIS. Gjatë periudhës 2023 janë skenuar gjithsej 2.469 shkresa, të cilat janë dorëzuar në sektorin kompetent.

Anonimizimi i vendimeve të gjykatës bëhet pa pengesa dhe në periudhën raportuese janë anonimizuar 2.924 vendime. Gjithashtu, veb portali i gjykatës tonë rregullisht përditësohet me raporte mujore, tre mujore dhe vjetore, si dhe me të gjitha informacionet e duhura për palët. Gjithashtu, Gjykata e Apelit Gostivar rregullisht e ndjek punën e gjykatave themelore në rajonin e këtij apeli në lidhje me dërgesën elektronike, regjistrimit me zë si dhe procesit të anonimizimit dhe shpalljes së vendimeve gjyqësore.

Në saje të pajisjeve të harduerit, gjatë vitit 2023 është kryer prokurim i 14 kompjuterëve të rinj, me të cilët janë përmirësuar kushtet e punës. Por gjykata akoma ka nevojë për tu pajisur dhe për tu përditësuar me mjete të reja.

Probleme në punë na shkakton rrjeti i vjetërsuar i gjykatës kapaciteti i të cilës aspak nuk i përmbush nevojat e funksionimit normal, me çka është e nevojshme që të bëhet kyçje e rrjetit të ri.

Gjykata edhe këtë vit u ri-certifikua për sistemin e menaxhimit të kualitetit ISO 9001:2015, me të cilën vendos, dokumenton, zbaton dhe mban sistemin për përmirësim të vazhdueshëm të tij.

Puna me ABMS sistemin po zhvillohet pa pengesa, në kohë dhe përditësohet dhe gjatë periudhës raportuese nuk janë paraqitur probleme.

Rritja e teknologjisë informatike gjithmonë shfaq nevojën për përditësim edhe dhe specializim i të gjithë të punësuarve të gjykatës për mënyrën e funksionimit të tij.

## **12. RAPORT PËR PAJISJET DHE MIRMËBAJTJEN E NDËRTESESË SË GJYQIT**

Ndërtesa e Gjykatës së Apelit Gostivar është e vendosur në rrugën ‘Zhivko Brajkovski’ nr.1 në Gostivar.

Hapësirat e punës së Gjykatë të Apelit Gostivar janë në katin e tretë të objektit të Gjykatës Themelore Gostivar, në dispozicion ka 27 zyra, një sallë gjykimesh, dy magazina dhe një hapësirë të serverit.

Hapësirat ku janë të vendosur gjykatësit dhe nëpunësit gjyqësor janë të pajisura me mobiljet e duhura dhe mjetet informatike. Çdo gjykatës ka kompjuterin e tij dhe ka qasje në AKMIS sistemin dhe internet. Shtypja e vendimeve bëhet përmes printerëve të vendosur në rrjet, me çka kursehet në mjete dhe në pajisje dhe ashtu është më ekonomike për eksploatim. Është ndërtuar hapësirë e veçantë për serverin.

Çdo zyrë është e kondicionuar dhe është e kyçur në sistemin qendror të ftohjes dhe ngrohjes.

Gjykata ka një sallë për gjykime, me sistem të regjistrimit të zërit, e cila nuk i plotëson kushtet e gjykatës.

Lëndët arkivohen në dollap prej metali të cilat janë të vendosura në korridore.

Bashkëpunëtorët gjyqësorë janë të vendosur nga dy ose tre në një hapësirë. Procesmbajtësit janë të vendosur nga tre persona në dy hapësira, por tash për tash nuk ka mundësi për çfardo lloj zgjerimi. Kjo situatë mund të përmirësohet vetëm nëse ndonjë nga institucionet që janë të vendosur në këtë ndërtesë (Prokuroria e Lartë Publike, Prokuroria Themelore Publike dhe Avokati i shtetit Gostivar) do të rilokalozohen në një ndërtesë tjetër.

Nga prioritetet për përmirësim të gjendjes në gjykatë është ndërtimi i ashensorit, për shkak se hapësirat e Gjykatës së Apelit Gostivar janë në katin e tretë të ndërtesës së Gjykatës Themelore Gostivar dhe nuk i plotësojnë kushtet për qasje të personave me nevoja të veçanta dhe personave të tjerë me ndonjë lloj pa-aftësie.

Rikonstruimi i sallës së gjykimeve, e cila nuk i përmbush aspak nevojat e gjykatës.

### **13. RAPORT PËR PROKURIMET PUBLIKE TË KRYERA DHE TË PLANIFIKUARA**

Gjatë vitit 2023, Gjykata e Apelit Gostivar punoi në realizimin e prokurimeve publike të cilat ishin në korniza të planit vjetor të paraparë për prokurime publike për vitin 2023. Numri më i madh i prokurimeve publike gjatë vitit janë rezultat i prokurimeve vjetore që bëhen çdo vit për nevojat e gjykatës, gjithashtu edhe kryetari i gjykatës angazhohet në realizimin e disa procedurave për prokurime publike të mallit, shërbimeve dhe punëve përmes sistemit për prokurime publike dhe atë:

- prokurim i inventarit të vogël dhe mjeteve për mirëmbajtje të higjienës;
- prokurim i kompjuterëve të ri;
- prokurim i materialit për zyra;
- prokurim i dritave led;
- prokurim i lëndëve djegëse për veturat zyrtare;
- prokurim i shërbimeve të internetit;
- prokurim në grup i shërbimeve të Postës së Maqedonisë;
- prokurim në grup i letrave për shtypje dhe kopjim;
- prokurim në grup dhe përmirësim i instalimit të sistemit për regjistrim audio Femida;
- prokurim i shërbimeve për shfrytëzim të linjës fikse telefonike;
- prokurim i Gjykatës së Apelit Gostivar për çertifikatën e sistemit të menaxhimit për kualitetin ISO 9001:2015;
- mirmëmbajtje e hapësirave të gjykatës.

Të gjithë prokurimet e planifikuara në tërësi dhe në kohë u realizuan, pas dinamikës së vërtetuar më parë nga ana e personave përgjegjës për kryerjen e prokurimeve në fjalë, ndërsa në pajtim me nevojat momentale të gjykatës.



Gostivar, Shkurt 2024.